

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA NË VITI, Departamenti i përgjithshëm si gjykatë penale e shkallës së parë, duke vendosur sipas gjyqtarit Xhavit Haziri me sek.juridike Naime Ibishi, në çështjen penale të akuzuari K.M. për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe nenit 54.1 të LSKRR-së, sipas aktakuzës PP.II. nr.837/2016 të datës 20.05.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt 21.03.2017. gjyqtari pa prezencën të njetën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K..M. nga babai Q. dhe nëna E.e lindur R., data e lindjes në Viti, me vendbanim në fsh,xxx imartuar,babë i xx fëmijve puntorë i thjeshtë, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 25.04.2016 rreth orës 20:20 minuta, në rrugën regjionale Viti-XXX, derisa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e markës "Daimler Benz 124" me targa të regjistrimit 0xx-xx.AL, ngjyrë hiri metalike, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezikjetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që me të arritur përball marketit "xxx", duke mos ia përshtat automjetit shpejtësinë e lëvizjes, në mënyrë që automjetin e vet ta ndal para qdo pengese në rrugë, e në kundërshtim me dispoziën ligjore nga neni 54.1 të LSKRR-së, me pjesën e përparme të anës së djathtë, (me ansore dhe pasqyren e djathtë), i godet këmbësorët V. dhe M. H., të cilat ishin në përfundim të trupimit të rrugës, me që rast të njejtave u shkakton lëndime trupore, e të cilat për shkak të lëndimeve të pësuar kanë qenë të detyruara të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjiilan.

Me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe nenit 54.1 të LSKRR-së

Gjykata duke u bazuar në këto dispozita ligjore të nenit 7, 17, 21, 41, e 46 të KPRK-ës si dhe nenit 360, 361, 365 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Me dënim gjobë prej 300,00 (treqind euro) të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën

dënimi i tillë do të zëvendësohet me dënim burgu ne kohëzgjatje prej 15 ditësh duke llogaritur çdo dite te kaluar ne burg nga 20 euro.

Të dëmtuarat V.H.dhe M.. H., udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro gjithashtu në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Shtetërore me datën 20.05.2016 ka ngritur aktakuzë PP. II. nr. 837/2016 kundër të akuzuarit K. M.i nga Fsh....K.Viti , për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se dhe nenit 54.1 te LSKRR-së.

Ne fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu deklaroi: Mbetem në tërsi pran aktakuzës së paraqitur dhe propozimeve që e njëjta i përmban pasi që gjendja faktike në këtë qështje penale juridike u vërtetua me pranimin e fajsisë te akuzuarit, pranim qe është ne përputhshmëri të plotë ne prova të tjera te cilat janë propozuar per tu shtjelluar për të vërtetuar ne mënyrë te plotë dhe të drejtë gjendjen faktike.Me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit i propozon gjykatës qe ti merr parasysh te gjitha masat si ato rënduese ashtu edhe ato lehtësuese ndërsa ne anën tjetër edhe faktin se i pandehuri është sjellur korrekt në gjykatë dhe e ka pranuar fajësinë.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzes ka kërkuar të merren parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, i ka propozuar gjykatës që t'i shqipton një dënim ma të butë, duke pasur parasysh gjendjen e varfër ekonomike, pendohet për veprën të cilën e ka kryer dhe një vepër të tillë nuk do ta përsërisë asnjëher.

Në shqyrtimin fillestar i akuzuari në tërsi e pranoi fajësinë sipas dispozitivit të aktakuzës. Gjykata ka qenë e bindur se i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë , se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari dhe pranimi i fajësisë është mbështetur në faktet që përmban aktakuza, në provat e prezentuara nga prokuroria të cilat kanë qenë të pranuar nga i akuzuari.

Duke vlerësuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit , gjykata fare nuk i shtjelloi provat ngase gjendja faktike në këtë qështje penale nuk ishte kontestuese, I akuzari pranimin e fajësisë e bëri duke mos kontestuar asnjë fakt nga dispozitivi i aktakuzes.

Pra një gjendje të këtillë faktike të pa kontestuar gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-së dhe nenit 54.1 të LSKRR-s.

Me rastin e matjës dhe shqiptimit të dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrehanë lehtësuese gjykata morri parasysh pranimin e fajësisë, me gjendje të vështir ekonomike, i pa punë, është person familjar, pendimin dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej kurrfar vepra penale te këtij lloji apo lloji tjetër dhe se te dëmtuarave u ka kërkuar falje për aksidentin që kishte ndodhur. Ndërsa si rrehanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar të dëmtarave sipas ekspertizës mjeko ligjore te leshuar nga zyra sherbyese “xxx” me datën 18.05.2016 dhe raportin nga Shtepia e Shendetit ne Viti me datën 25.04.2016

Për këtë arsye i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky dënim do të ndikoi pozitivishtë tek i akuzuari për mos përsëritje të veprave të tjera penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndersa vendimi mbi kërkesën palurore juridike konfomr nenit 463 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA NË VITI

Pnr. 291/2016

Me 21.03.2017

**Sek.juridike
Naime Ibishi**

**Gj y q t a r i,
Xhavit Haziri**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykim mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.